

Komuna e Gjakovës - Opština Džakovica  
Drejtorija për Punë të Përgjithshme Administrative  
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove

Nr./B. 419/04-1324  
Data 11.01.2019  
Gjakovë - Djakovica - Gjakova

Posta e Kosovës SH.A.  
Poste of Kosovo  
Prishtinë - Pristina

Nr./B. 01-316/19  
Data/Date/Datum 12-02-2019  
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

Ndërmarrja Publike Qendrore  
**Posta e Kosovës Sh.A.**

**KONTRATË PËR KRYERJEN E SHËRBIMEVE POSTARE  
(Shpërndarja e Faturave të Tatimit në Pronë)**

Komuna e dhe Posta e Kosovës Sh.a, lidhin këtë kontratën duke pas parasysh kontratën e lidhur në mes të Ministrisë së Administratës Publike (MAP) dhe Postës së Kosovës Sh.a. më datë: 29.03.2017 me Nr. Prot.:01-905/2017.

**KRYESI I SHËRBIMEVE:** **Posta e Kosovës SH.A.** Adresa; rr. 28 Nëntori, nr. 4, 10,000, Prishtinë, Kosovë. Me numër të biznesit (70847701). E përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor z. **Sejdi Hoxha**, Kryeshef Ekzekutiv i PK SH.A., në tekstin e mëtejme : Kryesi i Shërbimeve, dhe

**POROSITËSI I SHËRBIMEVE:** **Komuna e Gjakovës , Rr. "UÇK" (ish Bankosi)**, e përfaqësuar nga z.**Ardian Gjini , Kryetar i Komunës**, në tekstin e mëposhtëm : Porositësi i Shërbimeve.

**OBJEKTI I KONTRATËS:** Është printimi, zarfimi (me sigurimin e letrës dhe të zarfeve), si edhe shpërndarjen e dërgesave postare (faturave mbi tatimin në pronë të obliguesve tatimorë), në adresat e destinimit.

**AFATI KOHOR:** Kontrata për Kryerjen e Shërbimeve fillon prej **01/01/2019**, për një periudhe kohore prej një (1) viti, përkatësisht deri me datën **31/12/2019**, Kontrata hyn ne fuqi me nënshkrimin nga te dy palët. Palët që nënshkruajnë, me marrëveshje të shkruar, vendosin për shërbimet e kërkuara/ofruara gjatë vitit 2019.

Në bazë të kësaj kontrate, kryerësi i shërbimeve dhe porositësi i shërbimeve bien dakord si në vijim:

**Neni 1  
Përkufizime**

Në këtë Kontratë për kryerjen e shërbimeve, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e përdorur kanë kuptimet e dhëna më poshtë:

**Kontratë** - do të thotë kjo Kontratë, me ndryshimet dhe plotësimet eventuale sipas nenit 4.2 të saj;

**Kryerësi i shërbimeve** - do të thotë: Posta e Kosovës SH.A.

**IT** - do të thotë Departamenti i cili kryen printimin e faturave, zarfimin e tyre;

**PK SH.A** - do të thotë Posta e Kosovës SH.A e cila do të bëjë shpërndarjen e dërgesave postare (Faturave të Tatimit në Pronë) në adresat e destinimit;

**Porositësi i shërbimeve** - do të thotë: Komuna

**Afat** - ka kuptimin e dhënë në Nenin 2

**Periudhë e fiksuar** - ka kuptimin e dhënë në Nenin 2;

**Tarifa Postare** - ka kuptimin e “*Listës së Çmimeve të Shërbimeve Postare*”;

**Objekte Postare** - ka kuptimin e dërgesave që nënkupton të gjitha shërbimet që kryen kryerësi i shërbimeve të përfshira në këtë kontratë;

**Personi kontaktues** - ka kuptimin e personit, me të cilin bëhen kontaktet në lidhje me zbatimin e kësaj kontrate;

**Printimi i faturave** - nënkupton printimi i faturave të obliguesve tatimore në bazë të shënimeve të marra nga baza e të dhënave nga Ministria e Financave (MF);

**Zarfimi** - nënkupton futjen e faturave dhe materialeve tjera në zarfe dhe përgatitja për shpërndarje.

## **Neni 2 Detyrimet e Palëve**

2.1. Kryerësi i Shërbimeve, do të bëjë Printimin, Zarfimin (dhe sigurimin e letrës dhe të zarfeve) dhe Shpërndarjen e dërgesave postare (faturave mbi tatimin në pronë të obliguesve tatimor), në adresat e destinimit.

2.2. Kryesi i shërbimeve, detyrohet të bëjë pranimin e shënimeve nga baza e të dhënave të porositësit të shërbimeve dhe të njëjtat shënime do të futen në faturat përkatëse, me të cilat behet faturimi i tatimit, në pronë të detyrimeve tatimore, mandej do të bëhet printimi i faturave në fjalë, zarfimi dhe pastaj shpërndarja e tyre deri te adresa e tatimpaguesit.

Në këtë mënyrë faturat e gatshme të përgatitura për shpërndarje nga kryesi i shërbimeve (TI) kalojnë tek kryesi i shërbimeve (PK SH.A) për shpërndarje të tyre në adresat e destinimit.

2.3. Kryesi i shërbimit, për shërbimet e kryera, pregadit faturat për pagesë për Komunën. Pagesa e faturave, duhet të behet në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të faturës.

2.4. Faturat e përgatitura nga kryesi i shërbimit, do t'i dorëzohen Komunë.

2.5. Kryerësi i shërbimeve, duhet të njoftojë porositësin e shërbimeve, mbi shpërndarjen e faturave në fjalë për Komunën.

2.6. Kryesi i shërbimit, duhet të përfundojë printimin, zarfimin, shërbimet përcjellëse postare dhe shpërndarjen e të gjitha faturave tatimore për vitin 2019, në afatin e paraparë ligjor, Në rast të kërkesës, për shërbim shtesë ose ndryshim shërbimi gjatë vitit 2019,

detajet përkufizohen në një shkresë të veçantë me shkrim, me miratimin e palëve, si aneks i kësaj kontrate.

2.7. Kryesi i shërbimit siguron të dhënat për obliguesit tatimore për Komunën, nga departamenti përkatës në MF, me të gjitha shënimet bazë të të gjithë obliguesve tatimorë, për të cilat duhet të përgatiten faturat për tatim në pronë dhe që, pas përgatitjes, do të shpërndahen nga kryesi i shërbimeve.

### Neni 3 Kushtet e Pagesës

3.1 Kryesi i shërbimeve për shërbimet e bëra nga neni paraprak i kësaj kontrate përmes faturës ja faturon shërbimet e bëra porositësit të shërbimit. Faturat do të tarifohen në emër të Komunës.

3.2 Kryesi i Shërbimit për shërbimet e bëra – printim, zarfim, dhe shpërndarje të këtyre dërgesave i faturon porositësit të shërbimit me çmimin si në tabelën në vijim:

**Tabela 1 : Letërdërgesat postare të thjeshta “THJ” pesha 50 gr**

Nr.	Përshkrimi i artikullit-lloji i shërbimit	Pesha gr.	Shtypja A4 bardh /zi çmimi rritet për çdo faqe shtesë	Faqe	Zarfi C5 përdoret për dërgesa deri në 5 fleta ndërsa C4 për për dërgesat me mbi 5 fletë	Thyerje dhe zarfim për një dërgesë	Total printimi sipas faqeve	Gjithsejtë	Shërbimi i dërgesës Thjeshtë THJ	Çmimi total për njësi (€)
1	Dërgesa e thjeshtë THJ (bardh e zi)	deri 50 gr.	0.028	3	0.05	0.045	0.084	0.18	0.40	0.579
2	Dërgesa e thjeshtë THJ (bardh e zi)	50-100	0.028	8	0.10	0.045	0.224	0.37	0.50	0.869
3	Dërgesa e thjeshtë THJ (bardh e zi)	100-250	0.028	45	0.10	0.045	1.260	1.41	0.70	2.105
4	Dërgesa e thjeshtë THJ (bardh e zi)	250-500	0.028	95	0.10	0.045	2.660	2.81	1.10	3.905
5	Dërgesa e thjeshtë THJ (bardh e zi)	500-1000	0.028	195	0.10	0.045	5.460	5.61	1.50	7.105
6	Dërgesa e thjeshtë THJ (bardh e zi)	1000-2000	0.028	395	0.10	0.045	11.060	11.21	2.50	13.705

3.4. Porositësi i shërbimit obligohet që pagesën për taksën postare ta beje në llogarinë bankare të Posta e Kosovës SH.A. nr. Llogarisë: **2011000057926791**, në **Bankën Teb Sh.A, Kosovë** sipas faturës se dorëzuar në afatin e parapare ligjore me shenjen për të hyrat e “Posta e Kosovë SH.A”.

### Neni 4

#### Ndryshimi i Kontratës

4.1. Ndryshimet në këtë Kontrate, duhet të bëhen vetëm me shkrim, me nënshkrime të Përfaqësuesve të Autorizuar, me autorizim të Titullarëve të Institucioneve respektive, për çdo rast.

4.3. Çdo çështje e patrajtuar në këtë Kontratë, do të zgjidhet me pajtimin dhe shqyrtimin e palëve kontraktuese në përputhje me Ligjin „Mbi Shërbimet Postare” dhe legjisllacionit përkatës në fuqi.

## **Neni 5 Përgjegjësitë**

5.1. Kryesi i Shërbimeve, është përgjegjës për çdo dëm të shkaktuar në pajisjet për shkak të akteve ose mosveprimeve të tij, nga pakujdesia, keq shfrytëzimi ose keqpërdorimi prej personelit të tij, qoftë ky i prekshëm ose i paprekshëm, në të secilin prej rasteve të lartpërmendura, të cilat ndodhin gjatë përmbushjes ose në lidhje me përmbushjen e kësaj Kontrate.

5.2. Çdo dërgesë postare që është objekt reklamacioni do të trajtohet sipas ligjeve dhe akteve nënligjore që janë në fuqi në kohën e paraqitjes së reklamacionit.

5.3. Kryesi i Shërbimeve nuk mban përgjegjësi nëse këto janë të natyrës që përshkruhet në Nenin 6 (Forcë Madhore).

## **Neni 6 Forca Madhore**

6.1. Nëse, në çdo kohë, gjatë afatit kohor, të përcaktuar në këtë Kontrate, përmbushja plotësisht ose pjesërisht nga secila Palë, e çdo detyrimi sipas kësaj Kontrate, pengohet ose vonohet për shkak të luftës, luftës civile, armiqësisë, akteve të armikut publik, rebelimit, revolucionit, fuqisë ushtarake ose të uzurpimit, shqetësimeve civile, demonstratave ose kërcënimeve të menjëhershme lidhur me gjithë sa më lart, sabotazhit, zjarrit, përmytjes, shpërthimeve, epidemive, kufizimeve për shkak të karantinës, shqetësimeve në furnizime nga burime normalisht të besueshme (ku përfshihen por jo vetëm elektricitet, ujë, naftë dhe të ngjashme), greva, përjashtime, vendime qeveritare ose ndonjë ngjarje tjetër jashtë kontrollit të arsyeshëm të Palës në fjalë (këtu e më poshtë e përmendur si “*ndodhia*”), atëherë përmbushja e këtyre detyrimeve do të falet në masën që u pengua ose u vonua dhe pala e prekur ka marrë njoftim për këtë ndodhi, nga Pala tjetër brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e ndodhiesë, duke pasur parasysh që ngjarja e çdo ndodhie, nuk justifikon asnjë detyrim të secilës Palë për të kryer pagesa.

6.2. Asnjëra Palë, për shkak të ndodhiesë, nuk ka të drejtë të zgjidhë këtë kontratë ose të ngrejë pretendime për dëme kundër palës tjetër, në lidhje me mos përmbushjen ose vonesën në përmbushje. Përmbushja e detyrimeve të cenuara, duhet të rifillojë sapo të jetë praktike pas përfundimit ose pushimit të ndodhiesë në fjalë.

6.3. Nëse përmbushja tërësisht ose pjesërisht e ndonjë detyrimi sipas kësaj kontrate vonohet për shkak të ndonjë ndodhie të tillë, për një periudhë që tejkalon 3 (tre) muaj, Palët do të takohen dhe rishikojnë në mirëbesim dëshirueshmërinë dhe kushtet për zgjidhjen e Kontratës.

## **Neni 7 Kontrata e Plotë**

Palët bien dakord se kontratat dhe mirëkuptimi ne mes tyre, përfundon prej datës efektive të kësaj kontrate, me kusht që, të gjitha shumat që përbëjnë detyrim ndaj secilës Palë, sipas kontratës së mëparshme, mbeten ende detyrime dhe të pagueshme.

### **Neni 8 Zgjidhja e Kontratës**

- 8.1. Kontrata ka efekt ligjore me nënshkrimin nga të dyja palët dhe përfundon më 31 Dhjetor 2019.
- 8.2. Zgjidhja e kontratës është e mundur edhe nëse dispozitat ligjore mbi shërbimet postare e parashohin një mundësi të tillë dhe legjislacioni tjetër përkatës në fuqi.

### **Neni 9 Përfaqësuesit**


Për Kryesin e Shërbimit, Personi Kontaktues do të jetë znj. Pranvera Hasani, me nr. tel +383/44300221, e-mail: [pranvera.hasani@postakosoves.com](mailto:pranvera.hasani@postakosoves.com) apo nga **Shitja - PK Sh.A.**, nr. tel: 038221841 e-mail: [shitja\\_pk@postakosoves.com](mailto:shitja_pk@postakosoves.com).


Për Porositësin e Shërbimit, Personi Kontaktues do të jete z. Shkelzen Cermjani, me tel. 00386/49920919 dhe e-mail: [shkelzen.cermjani@rks-gov.net](mailto:shkelzen.cermjani@rks-gov.net).

### **Neni 10 Ligji dhe Juridiksioni**

- 10.1. Në rast të çdo mosmarrëveshjeje, që lind për shkak ose në lidhje me përmbushjen ose interpretimin e kësaj kontrate, Palët, bien dakord të takohen dhe të negociojnë në mirëbesim, për të arritur një zgjidhje miqësore, në mungesë të së cilës, vendimin për zgjidhje të mosmarrëveshjes, do ta marrë Gjykata kompetente e Prishtinës.
- 10.2 Kjo Kontratë hartohet dhe nënshkruhet në **tre (3)** kopje origjinale në gjuhën shqipe, për të dy (2) Palët nga një (1) kopje origjinale, dhe një (1) kopje për Departamentin e Tatimit në Pronë.

**PËR DHE NË EMËR  
TË KRYESIT TË SHËRBIMEVE**

  
z. Sejdi HOXHA  
Kryeshef Ekzekutiv, **PK SH.A.**



**PËR DHE NË EMËR  
TË POROSITESIT TË SHËRBIMEVE**

  
z. Ardian GJINI  
Kryetar i Komunes, Gjakovë



Më: 31/12/2018.